



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI**

**Gjashtëmujori i dytë 2019**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

**Shkurt 2020<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Vrojtimi është hedhur në terren gjatë muajit nëntor 2019 dhe mbulon zhvillimet mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve për gjashtëmujorin e dytë 2019 (maj-nëntor), si edhe pritshmëritë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit .....	2
Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri.....	4
1- Organizimi dhe fusha e veprimit.....	4
2- Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë .....	7
3- Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve.....	12
4- Struktura e huasë .....	15
5- Ngarkesa e huasë .....	17
6- Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen .....	20

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit

Për këtë vrojtim u përdor një kampion prej rreth 1360 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, 1110 ndërmarrje ose 81.7% e totalit morën pjesë në vrojtim duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Vlerësimet në vrojtim janë realizuar mbi bazën e numrit të ndërmarrjeve të përgjigjura dhe klasifikimit përkatës të tyre.

### • GJENDJA FINANCIARE

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019, *konkurrenca dhe gjetja e tregut* vlerësohen si faktorë të rëndësishëm kufizues për të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha). Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019, rëndësia e tyre vlerësohet disi në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Elementet që kanë shfaqur rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve për periudhën janë kostot e financimit dhe disponueshmëria e stafit të kualifikuar.

*Ecuria e shitjeve* vijon të vlerësohet në rritje, gjatë gjashtëmujorit të parë 2019, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla, por në përmirësim krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet e vogla kanë vlerësuar *ulje të rezultatit financiar* gjatë periudhës, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë vlerësuar *rritje* të tij. Të tre grupet e ndërmarrjeve duket se kanë bërë përpjekje pozitive për zgjerim të veprimtarisë së tyre gjatë periudhës, më e shprehur tek ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha. *Pritshmëritë e ndërmarrjeve* të të gjitha madhësive mbeten pozitive lidhur me shitjet, rezultatit financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë, por ato paraqiten më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2019, më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të vogla (rreth 57%) e të mëdha (rreth 53%) kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre kryesisht nëpërmjet *shitjeve*, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme (rreth 54%) kanë preferuar kryesisht *një kombinim burimesh*. Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019, mbështetja vetëm tek *shitjet* është zvogëluar për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vazhdon të zëjë një peshë të konsiderueshme dhe të zgjeruar gjatë periudhës për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Kombinimet më të përdorura vijnë të mbeten ato mes shitjeve dhe huasë, apo shitjeve dhe financimit me burime të brendshme.

### • HUAMARRJA

Rreth 37% e totalit të ndërmarrjeve (410 ndërmarrje) shprehen se *kanë një hua për të paguar*. Kjo peshë ka shënuar një rënie me 1.6 pikë përqindje (në vijim, pp) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 5.2 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rënie krahasuar me periudhën e kaluar në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha (me respektivisht 0.5 pp dh 3.4 pp), ndërkohë që kjo peshë ka shënuar një rritje të lehtë prej 1.9 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme.

Në total, *burimet formale të huamarrjes* (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 91% e ndërmarrjeve huamarrëse të përgjigjura, në rënie me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm. Ndër to, rreth 86% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar

si burim i vetëm huamarrjeje, ose 2.8 pp më pak krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019. Kombinimi i burimeve *formale* dhe atyre *informale* është përdorur nga 5% e ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për *kryerjen e investimeve afatgjata* (rreth 45% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për *të përballuar shpenzimet korrente* (30% e ndërmarrjeve të përgjigjura). Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për kryerjen e një investimi është rritur për ndërmarrjet e mesme, ndërkohë që huamarrja me qëllim përballimin e shpenzimeve ka rënë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Rreth 68% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, rreth 86% e ndërmarrjeve të mesme dhe 80% e atyre të mëdha, e konsiderojnë *të përshtatshëm* nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është më e ulët për ndërmarrjet e vogla dhe lehtësisht më e ulët për ato të mëdha, ndërkohë që është rritur për ato të mesme.

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në *monedhën vendase* për 57% të ndërmarrjeve të vogla, 5% të ndërmarrjeve të mesme dhe 36% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Huamarrja *në valutë*, kryesisht në euro, rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (54% e tyre), duke tejkaluar monedhën vendase, dhe më pak tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (përkatësisht 35% dhe 38% e tyre).

Vlera totale e huasë rezulton *afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes* për rreth 78% të totalit të ndërmarrjeve huamarrëse dhe *e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit* për afërsisht 22% të tyre. Të analizuar sipas madhësisë, raporti hua/kapital ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 23% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh të tyre. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezulton më e theksuar tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë.

#### • MARRËDHËNIA ME BANKAT

*Procesi i huamarrjes nga bankat* vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", në zbatim krahasuar me periudhën e kaluar për ndërmarrjet e mëdha, por në rritje për ato të vogla. *Marrëdhënia me bankat* vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", por disi në rënie tek të tre grupet e ndërmarrjeve, më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të vogla.

Lidhur me elementet që vështirësojnë përfitimin e një kredie bankare, *kostoja e lartë e kredisë* vijon të cilësohet si elementi kryesor veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla. Vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar.

Lidhur me planifikimin e një huamarrjeje në të ardhmen, rreth 48% e ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se *nuk ka asnjë mundësi* që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, kjo peshë ka rënë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por është rritur për ato të mëdha. Nga ana tjetër, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve të vogla që pohojnë se *ka pak mundësi* të marrin një kredi në gjysmën e parë të vitit 2020, ndërkohë që është rritur pesha e ndërmarrjeve të mesme që shprehen se *ka shumë mundësi* që diçka e tillë të ndodhë në gjashtëmujorin e ardhshëm. Gjithashtu, të gjitha grupet e ndërmarrjeve, por veçanërisht ato të mesme dhe të mëdha, kanë shënuar një rritje për alternativën "*është e sigurt*", duke u paraqitur më optimiste në planifikimin e huamarrjes. Kjo ecuri mund të sinjalizojë një rritje të kërkesës për kredi në afatin e shkurtër dhe të mesëm.

## Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri

**Karakteristikat e kampionit të vrojtuar.** Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet që prej gjashtëmujorit të dytë 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Fillimisht, ky vrojtım u hodh në terren me një kampion të përzgjedhur prej 700 ndërmarrjesh me *turnover*-in më të lartë (ndërmarrje të mëdha). Më tej, në vitin 2016, kampioni u zgjerua në rreth 1200 ndërmarrje të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin. Në gjashtëmujorin e dytë 2019, vrojtimi u realizua mbi një kampion total prej 1360 ndërmarrjesh, të shpërndara në 12 qarqet e vendit. Pjesa kryesore e këtyre ndërmarrjeve (rreth 80%) janë përqendruar në 4 qarqe, përkatësisht në: Tiranë (rreth 52%), Durrës (rreth 15%), Fier (rreth 7%) dhe Shkodër (rreth 5%).


Në totalin e kampionit të përzgjedhur, rreth 82% e ndërmarrjeve (1111 gjithsej) i janë përgjigjur pyetjeve të vrojtimit dhe analiza e rezultateve mbështetet në këto përgjigje. Në kushtet e një kampioni të zgjeruar, analiza e mëposhtme është organizuar kryesisht bazuar në ndarjen sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

### 1. Organizimi dhe fusha e veprimit

#### 1.1 Shpërndarja sektoriale dhe madhësia e ndërmarrjeve


Për gjashtëmujorin e dytë 2019, në ndarjen sipas sektorëve, rreth 38% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të *industrisë*, rreth 30% sektorit të *shërbimeve*, rreth 14% sektorit të *ndërtimit* dhe rreth 18% sektorit të *tregtisë*. Sipas madhësisë, rreth 21% e ndërmarrjeve klasifikohen si *ndërmarrje të vogla* (5-19 persona të punësuar), rreth 17% si *ndërmarrje të mesme* (20-49 të punësuar), dhe rreth 62% si *ndërmarrje të mëdha* (mbi 50 të punësuar). Në grupin e *ndërmarrjeve të vogla*, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve (rreth 38%), ndjekur nga sektori i industrisë (rreth 25%). Nga ana tjetër, në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, peshën më të lartë e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (përkatësisht prej rreth 44% dhe 41%) dhe ato të sektorit të shërbimeve (respektivisht 23% dhe 30%).

**Grafik 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 1.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe sektorëve të ekonomisë**




## 1.2 Sigurimi i lëndës së parë dhe shitja e produkteve


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha (respektivisht rreth 62%, 45% dhe 42% e tyre) sigurojnë *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Krahasuar me periudhën paraardhëse (gjashtëmujorin e parë), ky tregues ka rënë me 1.8 pikë përqindje (pp) në rastin e ndërmarrjeve të vogla, ndërkohë që është rritur me 1.5 pp tek ndërmarrjet e mëdha dhe vetëm me 0.2 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme. Nga ana tjetër, rreth 37% e ndërmarrjeve të mëdha sigurojnë *deri në 20% të lëndës së parë brenda vendit*.

Shitja e produkteve vijon të mbetet *kryesisht brenda vendit*, ku rreth 79% e ndërmarrjeve të vogla, 64% e ndërmarrjeve të mesme dhe 57% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë deklaruar se kanë shitur shumicën e produkteve në tregun vendas (mbi 80% të produkteve). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, ka pasur një rritje të peshës së ndërmarrjeve të vogla e të mesme që i shesin produktet e tyre kryesisht brenda vendit (përkatësisht me 1.8 dhe 3.4 pp), ndërkohë që pesha e ndërmarrjeve të mëdha që deklarojnë një gjë të tillë, ka qenë në rënie (me 2.5 pp).

**Grafik 1.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së blerjes së lëndës së parë brenda vendit**



**Grafik 1.4 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së shitjeve brenda vendit**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke i analizuar përgjigjet sipas sektorëve, rezulton se sektori i ndërtimit ka një varësi më të madhe ndaj lëndës së parë të siguruar në vend, ku rreth 77% e ndërmarrjeve të këtij sektori siguron *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Kjo peshë është rritur me 1.1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë (gjashtëmujori i dytë 2018). Nga ana tjetër, sektori i industrisë shfaq varësi më të ulët, ku 49% e ndërmarrjeve të këtij sektori sigurojnë *vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit*. Gjithsesi, pesha e këtyre ndërmarrjeve ka vijuar të jetë në rënie përgjatë katër gjashtëmujorëve të njëpasnjëshëm. Për periudhën në analizë, shënohet një rënie si gjashtëmujore ashtu edhe vjetore, me rreth 3.6 pp dhe 7.1 pp përkatësisht.

**Tabelë 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe përqindjes së blerjes së lëndës së parë brenda vendit**

		Deri në 20%	20-50%	50-80%	Mbi 80%
Industri	6MI 2018	60.2%	8.1%	8.6%	23.0%
	6MII 2018	56.0%	4.8%	12.3%	26.9%
	6MI 2019	52.5%	10.5%	11.0%	26.0%
	6MII 2019	48.9%	8.6%	14.7%	27.8%
Shërbime	6MI 2018	24.2%	5.2%	7.0%	63.6%
	6MII 2018	27.3%	4.9%	8.4%	59.3%
	6MI 2019	18.6%	7.8%	11.9%	61.6%
	6MII 2019	18.2%	5.7%	13.1%	63.0%
Ndërtimi	6MI 2018	6.1%	5.6%	17.3%	70.9%
	6MII 2018	2.8%	3.3%	19.3%	74.6%
	6MI 2019	3.2%	2.6%	18.7%	75.5%
	6MII 2019	1.3%	3.2%	19.0%	76.6%
Tregtia	6MI 2018	42.8%	10.6%	12.8%	33.9%
	6MII 2018	46.7%	13.2%	13.7%	26.4%
	6MI 2019	33.5%	14.2%	15.2%	37.1%
	6M II 2019	30.6%	14.5%	19.2%	35.8%


Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 1.3 Elementet kufizuese në aktivitetin e ndërmarrjeve<sup>2</sup>

Elementet e konkurrencës dhe gjetjes së tregut vijojnë të mbeten sfidat kryesore në aktivitetin e ndërmarrjeve edhe gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, në krahasim me periudhën paraardhëse, rëndësia e tyre vlerësohet disi në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Elemente të cilat kanë shfaqur rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve për periudhën janë *kostoja e financimit* dhe *disponueshmëria e stafit të kualifikuar*.

<sup>2</sup> Ndërmarrjet kanë vlerësuar rëndësinë e disa problemeve të caktuara sipas një shkalle nga 1 deri në 10, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 10 është shkalla më e lartë e vështirësisë. Për të agreguar përgjigjet për secilën çështje të vlerësuar, është llogaritur një mesatare e ponderuar për të gjitha ndërmarrjet e përgjigjura, duke peshuar përgjigjet e tyre me shkallët e vlerësimit (1-10).

**Grafik 1.5. Vlerësimi i ndikimit të disa faktorëve në veprimtarinë e ndërmarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2. Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë


### 2.1 Monedha e kryerjes së veprimtarisë

Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vijon të mbetet i ulët dhe në rënie gjatë periudhës. Kështu, rreth 77% e ndërmarrjeve të vogla dhe 61% e atyre të mesme deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *plotësisht* ose *kryesisht*<sup>3</sup> në monedhën vendase. Përdorimi i valutës vijon të mbetet më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha, ku 34% e tyre deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *kryesisht* ose *plotësisht në valutë*. Gjithsesi, kjo peshë ka filluar të shënojë rënie (4 pp) pas tre periudhash të pandryshuara.

<sup>3</sup> Mbi 50% të veprimtarisë në lekë.



**Grafik 2.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe monedhës së kryerjes së veprimtarisë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.


## 2.2 Ecuria e shitjeve, rezultati financiar dhe zgjerimi i veprimtarisë

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2019, ndërmarrjet e vogla vijojnë të raportojnë rënie të nivelit të shitjeve me një balancë neto negative prej [4.3%], por në përmirësim në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Nga ana tjetër, situata ka rezultuar pozitive për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, të cilat kanë shënuar balanca neto pozitive të shitjeve, respektivisht me 8.5% dhe 24.9%, duke shfaqur gjithashtu një përmirësim krahasuar me periudhën paraardhëse. Për sa i përket pritshmërive për nivelin e shitjeve të përgjithshme në gjashtëmujorin e ardhshëm, të tre grupet e ndërmarrjeve vijojnë të jenë pozitive lidhur me ecurinë e tyre, duke pritur një rritje të nivelit të shitjeve. Sidoqoftë, ato paraqiten më pak optimiste përgjatë tre vrojtimeve të fundit.

**Grafik 2.2 Balanca neto e shitjeve**



**Grafik 2.3 Balanca neto e pritshmërive të shitjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e shitjeve/rritje e pritshmërive të shitjeve) dhe përgjigjeve negative (rënie e shitjeve/rënie e pritshmërive mbi shitjet) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.


Rezultatet paraqiten të ngjashme edhe për ndryshimin e rezultatit financiar në gjysmën e dytë të vitit 2019, duke ndjekur ecurinë e balancës së shitjeve të përgjithshme. Kështu, ndërmarrjet e vogla vijojnë të vlerësojnë rënie të rezultatit financiar gjatë periudhës, me një balancë neto negative prej [7.3%], e ngushtuar në krahasim me periudhën paraardhëse. Nga ana tjetër, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha vijojnë të

deklarojnë balanca pozitive të rezultatit financiar, respektivisht 10.1% dhe 19%, gjithashtu në përmirësim krahasuar me periudhën e kaluar. *Pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm* janë pozitive për të tre grupet e ndërmarrjeve, por më pak optimiste se në gjashtëmujorin paraardhës, çka shkon në të njëjtën linjë me pritshmëritë për ecurinë e shitjeve.

**Grafik 2.4 Balanca neto e rezultatit financiar**



**Grafik 2.5 Balanca neto e rezultatit financiar të pritshëm në gjashtëmujorin e ardhshëm**




Burimi: Banka e Shqipërisë.


Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e rezultatit financiar/ rritje e pritshmërive) dhe përgjigjeve negative (rënie e rezultatit financiar/rënie e pritshmërive) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Për sa i takon *zgjerimit të veprimtarisë* apo rritjes së investimeve për gjysmën e dytë të vitit 2019, të tre grupet e ndërmarrjeve kanë shënuar balanca neto pozitive, përkatësisht 1.7% në rastin e ndërmarrjeve të vogla, 12.2% për ndërmarrjet të mesme dhe 18.7% për ato të mëdha. Pritshmëritë më pak optimiste për ecurinë e shitjeve dhe rezultatit financiar mund të kenë ndikuar investimet apo zgjerimin më të kujdesshëm të ndërmarrjeve, ndërkohë që zgjerimi i periudhës së mëparshme ka nxitur përmirësimin e shitjeve dhe të rezultatit financiar gjatë periudhës aktuale. *Për gjashtëmujorin e ardhshëm* (6MI-2020), balancat neto të përgjigjeve kanë rezultuar pozitive për të tre grupet e ndërmarrjeve, çka nënkupton pritshmëri për investim apo zgjerim të mëtejshëm të veprimtarisë, por në krahasim me tre periudha paraardhëse të vrojtuar, këto pritshmëri paraqiten më pak optimiste për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

**Grafik 2.6 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë**



**Grafik 2.7 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë në gjashtëmujorin e ardhshëm**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (zgjerim i veprimtarisë/ pritshmëri për zgjerim apo investim) dhe përgjigjeve negative (ngushtim i veprimtarisë/pritshmëri për ngushtim) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

## 2.3 Niveli i shitjeve dhe rezultati financiar

Ecuria e agreguar e nivelit të shitjeve të përgjithshme është analizuar nëpërmjet një indeksi<sup>4</sup>, i cili peshon përgjigjet e ndërmarrjeve sipas intervaleve të ndryshme dhe i grupon ato sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sipas sektorëve.


Në ndarjen sipas madhësisë, ecuria e vlerave të indeksit tregon një rritje të nivelit të shitjeve për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, më e theksuar për ndërmarrjet e mëdha. Rezultatet e indeksit sipas sektorëve tregojnë se vlerat më të larta të shitjeve janë realizuar nga sektori i tregtisë dhe ai i ndërtimit, ndërkohë që vlerat më të ulëta vijnë të shënohen nga sektori i shërbimeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, indeksi i shitjeve paraqitet në rënie për të gjithë sektorët, më e theksuar në sektorin e tregtisë.

**Grafik 2.8 Indeksi i përgjithshëm i shitjeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 2.9 Indeksi i shitjeve të përgjithshme sipas sektorëve**



Për sa i përket *rezultatit financiar* për gjashtëmujorin e dytë 2019, kanë dhënë informacion vetëm 1064 ndërmarrje (ose rreth 78% e totalit të kampionit). Në grupin e ndërmarrjeve të përgjigjura, mbi 89% për secilin nga grupet sipas madhësisë kanë raportuar *fitim* gjatë periudhës. Kjo peshë ka rezultuar më e lartë tek ndërmarrjet e mesme (rreth 97%) dhe më e ulët tek ato të vogla (rreth 90%). Krahasuar me periudhën e mëparshme, pësha e ndërmarrjeve që kanë raportuar fitim ka qenë në rritje për të tre grupet e ndërmarrjeve.

**Grafik 2.10 Rezultati financiar sipas madhësisë së ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>4</sup> Koeficientët e ponderimit sipas intervaleve të shitjeve të përgjithshme janë: “Deri në 10 milionë lekë” = 0; “10-49 milionë lekë” = 0.25; “50-99 milionë lekë” = 0.5; “100-500 milionë lekë” = 0.75; “Mbi 500 milionë lekë” = 1. Rritja/ulja e vlerës së këtij indeksi nënkupton një rritje/ulje të nivelit të shitjeve të përgjithshme të ndërmarrjeve.


Për ndërmarrjet të cilat raportojnë fitim, të gjitha grupet e ndërmarrjeve pohojnë rritje të shitjeve të përgjithshme dhe të rezultatit financiar dhe zgjerim të veprimtarisë apo rritje të investimeve. Krahasuar me periudhën paraardhëse, balancat neto paraqiten të përmirësuar në rastin e nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, por më pak optimiste lidhur me zgjerimin e veprimtarisë së të gjitha madhësive të ndërmarrjeve. Në mënyrë të ngjashme me këtë të fundit, pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm vijojnë të mbeten pozitive, por balancat neto kanë rënë për të tre treguesit në krahasim me periudhën paraardhëse, për të tre grupet e ndërmarrjeve.

**Grafik 2.11 Balancat neto për ndërmarrjet me fitim**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 2.12 Balancat neto për pritshmëritë e ndërmarrjeve me fitim**




Për ndërmarrjet të cilat raportojnë humbje, të tre grupet e ndërmarrjeve raportojnë balanca negative për nivelin e shitjeve, rezultatit financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë apo rritjes së investimeve gjatë periudhës. Pritshmëritë e ndërmarrjeve me humbje paraqiten optimiste për gjashtëmujorin pasues në lidhje me nivelin e ardhshëm të shitjeve dhe rezultatit financiar për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, por gjithsesi negative lidhur me zgjerimin e veprimtarisë, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha.

**Grafik 2.13 Balancat neto të ndërmarrjeve me humbje**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 2.14 Balancat neto të pritshmërive të ndërmarrjeve me humbje**



## 2.4 Financimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të vogla (rreth 57%) e të mëdha (53%) kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre kryesisht nëpërmjet *shitjeve*, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme kanë preferuar kryesisht *një kombinim burimesh* (54%). Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019, mbështetja vetëm tek shitjet është ngushtuar për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vazhdon të zërë një peshë të konsiderueshme dhe të zgjeruar gjatë periudhës për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Kombinimet më të përdorura vijnë të mbeten ato mes shitjeve dhe huasë, apo shitjeve dhe financimit me burime të brendshme (rezerva të mbartura, rritje kapitali).

**Grafik 2.15 Financimi i veprimtarisë sipas madhësisë së ndërmarrjeve**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 3. Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve

Rreth 37% e totalit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur<sup>5</sup> (gjithsej 410 ndërmarrje) pohojnë që kanë një hua për të paguar dhe kjo peshë ka rënë me 1.6 pp krahasuar me vrojtimin e gjashtëmujorit të parë 2019 dhe me 5.2 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rënie krahasuar me periudhën e kaluar në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha (respektivisht me 0.5 pp dhe 3.4 pp), ndërkohë që kjo peshë ka shënuar një rritje prej 1.9 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme. Në ndarjen sipas sektorëve, pesha më e lartë e ndërmarrjeve huamarrëse rezulton në sektorin e tregtisë (rreth 53%), ndjekur nga sektori i ndërtimit (43%). Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse në të dy këta sektorë ka qenë e pandryshuar për tregtinë, por ndërtimi ka shënuar rënie në krahasim me periudhën e kaluar.

**Tabelë 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe huamarrjes**

Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë	Nr. i ndërmarrjeve		Pesha ndaj totalit të grupit	
	6MI 2019	6MII 2019	6MI 2019	6MII 2019
Të vogla	58	53	23.4%	22.8%
Të mesme	69	74	37.7%	39.6%
Të mëdha	309	283	44.3%	41.0%
<b>Total ndërmarrje</b>	<b>436</b>	<b>410</b>	<b>38.6%</b>	<b>37.0%</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.


<sup>5</sup> Duke marrë në konsideratë kampionin e plotë prej 1360 ndërmarrjesh, vetëm 1110 prej tyre ose rreth 82% kanë dhënë përgjigje.

Analiza e mëposhtme është realizuar duke u mbështetur vetëm në përgjigjet e ndërmarrjeve huamarrëse.

### 3.1 Burimi i huasë

Rreth 86% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim huamarrje, ndërsa mbi 8% e tyre e kanë kombinuar dhe me burime të tjera. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse nga bankat ka rënë me 2.8 pp krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019. Të ndara sipas madhësisë, rezulton se rreth 87% e ndërmarrjeve të vogla, 84% e atyre të mesme dhe 87% e ndërmarrjeve të mëdha i janë drejtuar vetëm bankave si burim huamarrje. Këto pesha kanë shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Përveç bankave, një pjesë e ndërmarrjeve i janë drejtuar dhe institucioneve financiare jobanka ose kanë kombinuar disa burime formale dhe informale (si hua nga kompani të tjera, persona fizikë, mall i papaguar etj.).

**Grafik 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas burimit të huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në total, *burimet formale të huamarrjes* (banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 91% e ndërmarrjeve huamarrëse të përgjigjura (93% e ndërmarrjeve të vogla, 91% e ndërmarrjeve të mesme dhe atyre të mëdha), në rënie me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm.

### 3.2 Qëllimi i huasë

Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për *kryerjen e investimeve afatgjata* (rreth 45% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për *të përballuar shpenzimet korrente* (30% e ndërmarrjeve të përgjigjura). Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për kryerjen e një investimi, është rritur për ndërmarrjet e mesme, ndërkohë që huamarrja me qëllim përballimin e shpenzimeve ka rënë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Të njëjtën prirje rënëse ka pasur dhe huamarrja për të shlyer një hua më të vjetër për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

**Grafik 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas qëllimit të përdorimit të huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3.3 Mjaftueshmëria e huasë

Gjatë periudhës, rreth 68% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 86% e ndërmarrjeve të mesme dhe 80% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është më e ulët për ndërmarrjet e vogla dhe lehtësisht më e ulët për ato të mëdha, ndërkohë që është rritur për ato të mesme. Pjesa tjetër e përgjigjeve ka rezultuar në balanca neto pozitive për ndërmarrjet e vogla dhe neutrale për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Kjo balancë tregon se pesha e ndërmarrjeve që do të preferonin më shumë hua është më e lartë se pesha e atyre që do të preferonin më pak hua për financimin e veprimtarisë në rastin e ndërmarrjeve të vogla, por rezulton e barabartë në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Duke e krahasuar këtë rezultat me atë të vërtetimit të kaluar, kërkesa për hua është paraqitur e ngushtuar në këtë periudhë.

**Grafik 3.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas mjaftueshmërisë së huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4. Struktura e huasë

### 4.1 Monedha

Për sa i përket monedhës së huamarrjes së ndërmarrjeve, gjatë periudhës, 57% e ndërmarrjeve të vogla, 56% e ndërmarrjeve të mesme dhe 36% e ndërmarrjeve të mëdha, deklarojnë se huaja e tyre është vetëm në monedhën vendase, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Gjatë periudhës, huamarrja në valutë (kryesisht në euro) rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (54% e tyre) dhe më pak nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (përkatësisht 35% dhe 38% e tyre). Ky element ndikohet edhe nga monedha në të cilën këto ndërmarrje kryejnë veprimtarinë e tyre. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, pesha e ndërmarrjeve me hua në monedhë të huaj ka rezultuar në rënie për grupin e ndërmarrjeve të vogla (prej 10 pp) dhe atyre të mesme (prej 7 pp), ndërkohë që ka shënuar një rritje të lehtë (prej 2 pp) në rastin e ndërmarrjeve të mëdha.

**Grafik 4.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas monedhës së huasë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 4.2 Marrja e huasë dhe afati i maturimit

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve kanë marrë hua në 1-5 vitet e fundit, përkatësisht rreth: 47% e ndërmarrjeve të vogla; 60% e ndërmarrjeve të mesme; dhe 45% e ndërmarrjeve të mëdha. Kjo peshë ka qenë në rënie krahasuar me një gjashtëmujor më parë për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha (respektivisht me 2.8 pp dhe 13 pp), ndërkohë që është rritur për ato të mesme (9.5 pp).

*Huamarrja e re*, e cila nënkupton huamarrjen në gjashtëmujorin e fundit, deklarohet nga 17% e ndërmarrjeve të vogla, rreth 5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 10% e ndërmarrjeve të mëdha. Në terma gjashtëmujorë, pesha e huamarrësve të rinj ka rezultuar në rritje vetëm për ndërmarrjet e vogla; ndërsa në terma vjetorë, rritje kanë shënuar edhe ndërmarrjet e mëdha. *Qëllimi kryesor i përdorimit të huamarrjes së re* ka qenë kryerja e një investimi afatgjatë (për 45% të totalit të ndërmarrjeve) dhe *përballimi i shpenzimeve korrente* (29% të totalit të ndërmarrjeve). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua të re për të përballuar shpenzimet korrente ka qenë në rënie, ndërkohë që pesha e atyre që kanë marrë hua të re për të kryer një investim afatgjatë rezultoi në rritje. Kjo prirje vihet re për të tre grupet e ndërmarrjeve. Afati mesatar i mbetur i huamarrjes ka rezultuar 57.4 muaj për ndërmarrjet e vogla, 61.6 muaj për ndërmarrjet e mesme dhe 61.2 muaj për ato të mëdha.





### 4.3 Norma e interesit të huasë dhe mënyra e shlyerjes

Lloji kryesor i normës së interesit të huasë më të madhe ekzistuese<sup>6</sup>, mbetet *norma e pandryshueshme deri në fund të afatit* (për 85% të ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mesme dhe 78% të atyre të mëdha) dhe *norma e ndryshueshme çdo vit* (për 13% të ndërmarrjeve të vogla, 7% të ndërmarrjeve të mesme dhe 16% të ndërmarrjeve të mëdha). Gjatë periudhës, pesha e ndërmarrjeve që raportojnë hua me normë të pandryshueshme ka rezultuar në rritje krahasuar me periudhën paraardhëse, në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në rënie për ndërmarrjet e mëdha. Për ndërmarrjet që raportojnë hua me normë interesi të ndryshueshme çdo vit, pesha e tyre është rritur vetëm për ndërmarrjet e mesme. Frekuenca e shlyerjes është kryesisht mujore, për 85% të ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 88% e ndërmarrjeve të mesme dhe 87% të ndërmarrjeve të mëdha.

### 4.4 Forma e kolateralit dhe raporti i mbulimit

Rreth 83% e ndërmarrjeve të vogla, 80% e ndërmarrjeve të mesme dhe 76% e atyre të mëdha, deklarojnë se huaja e marrë është e kolateralizuar *vetëm me pasuri të paluajtshme*, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve ka përdorur forma të tjera kolateralizimi<sup>7</sup>. Ndërkohë, rreth 6% e ndërmarrjeve të vogla, rreth 8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 9% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë se huaja e marrë është e pakolateralizuar. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve me hua të pakolateralizuar ka shënuar rënie në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha dhe një rritje të lehtë në grupin e ndërmarrjeve të mesme. *Mbulimi me kolateral* vlerësohet në mënyrë të agreguar përmes indeksit të peshuar të përgjigjeve<sup>8</sup>. Për gjashtëmujorin e dytë 2019, ky indeks ka rezultuar 0.69 për ndërmarrjet e vogla, 0.54 për ndërmarrjet e mesme dhe 0.66 për ato të mëdha. Krahasuar me periudhën e kaluar, raporti i mbulimit ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha.

**Grafik 4.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas formës së kolateralit të huasë**      **Grafik 4.3 Indeksi i mbulimit me kolateral**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>6</sup> Në rastin e ndërmarrjeve, të cilat kanë më shumë se një hua.

<sup>7</sup> Mjete financiare, dorëzani, garanci të tjera, së bashku me kombinimin e disa formash kolateralizimi, përfshirë edhe kombinimin me pasuritë e paluajtshme.


<sup>8</sup> Ky indeks merr vlera nga 0 në 1 dhe rritja e vlerës së tij tregon rritje të peshës së mbulimit me kolateral. Koeficientët e peshimit të këtij indeksi, sipas alternativave, janë: "deri në 50% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.25; "50-100% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.5; "100-120% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.75; "mbi 120% të huasë së kolateralizuar" = 1.

## 5. Ngarkesa e huasë

### 5.1 Vlera e huasë ndaj kapitalit

Gjatë periudhës, vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 78% të ndërmarrjeve huamarrëse dhe e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit për 22% të tyre. Raporti hua/kapital ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 23% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh të tyre. Sidoqoftë, ky raport ka qenë në rënie për të tre grupet e ndërmarrjeve në këtë gjashtëmujor.

**Grafik 5.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit hua/kapital**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezulton më e shprehur tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë, në ndryshim nga periudhat e mëparshme në të cilat ngarkesa me borxh ka qenë më e lartë për tregtinë dhe industrinë.

**Tabelë 5.1 Peshë e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve**

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MI 2018	22.4%	19.8%	15.2%	20.2%
6MII 2018	20.7%	14.9%	15.0%	29.6%
6MI 2019	26.8%	18.5%	18.3%	28.8%
6MII 2019	20.4%	28.0%	13.4%	26.5%

Burimi: Banka e Shqipërisë.


### 5.2 Shpenzimi për pagesën e huasë

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (67%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të ndërmarrjes. Kjo peshë ka rënë me 4.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Barra e pagesës së huasë ndaj totalit të të ardhurave duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku numri i

ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave, zë 52% të totalit të grupit<sup>9</sup>, ndërsa për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kjo peshë shënon respektivisht 33% dhe 29%.


Të pyetura nëse *kostoja e shërbimit të huasë ka ndryshuar* gjatë gjashtëmujorit të kaluar, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 94% e atyre të vogla, 92% e atyre të mesme dhe 93% e atyre të mëdha), pohojnë se ky shpenzim ka mbetur *i pandryshuar*. Përgjigjet e pjesës tjetër të ndërmarrjeve kanë rezultuar në balanca neto pozitive për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, duke treguar një rritje të këtij shpenzimi gjatë periudhës, ndërkohë që paraqitet negative për ndërmarrjet e mesme. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, kjo balancë ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, duke treguar një prirje shtrënguese të kostove të financimit nga bankat për këto ndërmarrje.

**Grafik 5.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 5.3 Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës**



### 5.3 Përballimi i kostos së huasë


Në rastin e rritjes së kostos së shërbimit të huasë, në më shumë se gjysmën e rasteve ndërmarrjet janë mbështetur në uljen e shpenzimeve të tjera (56%). Gjithashtu, për një pjesë të ndërmarrjeve (19%) është shitur një pjesë e veprimtarisë, janë përdorur rezervat e ndryshme apo janë rritur çmimet e produkteve (6%).

### 5.4 Ngarkesa me borxh

Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve huamarrëse gjatë periudhës vlerësohet lehtësisht më e ulët krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ku vlera e indeksit për totalin e ndërmarrjeve ka rezultuar 0.59. Sipas madhësisë, indeksi paraqet një rënie të ngarkesës me borxh për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm.

<sup>9</sup> Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: “20-50% të të ardhurave”, “50-80% të të ardhurave” dhe “mbi 80% të të ardhurave”.

**Grafik 5.4 Indeksi i ngarkesës me borxh të ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Indeksi llogaritet duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën “ngarkesë e lartë”, 0.5 për alternativën “ngarkesë mesatare” dhe vlerën 0 për alternativën “ngarkesë e ulët”.

## 5.5 Pritshmëritë për pagesën e këstit të huasë për gjashtëmuajorin e ardhshëm

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse, pavarësisht madhësisë së tyre (rreth 85%) nuk presin ndryshim të këstit të huasë në gjashtëmuajorin e parë 2020. Kjo peshë ka rënë me 2 pp në krahasim me periudhën paraardhëse. Për sa i përket ndërmarrjeve që presin ndryshim të këstit, rezulton se të tre grupet e ndërmarrjeve vijojnë të presin rënie të mëtijshme në këtë aspekt në gjashtëmuajorin e ardhshëm, veçanërisht ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, ndonëse ato paraqiten më pak optimiste krahasuar me gjashtëmuajorin e mëparshëm.

**Grafik 5.5 Pritshmëritë mbi ndryshimin e këstit të huasë në gjashtëmuajorin e ardhshëm**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 6. Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen<sup>10</sup>

### 6.1 Aksesimi në financim

Kërkesa e ndërmarrjeve për kredi vijon të mbetet e moderuar, ku vetëm 11% e tyre deklarojnë se kanë aplikuar për financim gjatë gjashtëmujorit të fundit. Kjo peshë rezulton pothuaj në të njëjtin nivel me vrotimin e kaluar, me një ngushtim prej 0.3 pp. Duke e analizuar këtë tregues sipas madhësisë së ndërmarrjeve, rezulton se peshën më të lartë vijnë ta kenë ndërmarrjet e mëdha (rreth 12%). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, vërehet një tkurrje e lehtë e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e vogla e të mëdha dhe një rritje e kërkesës vetëm nga ndërmarrjet e mesme.

**Grafik 6.1 Kërkesa për financim e ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për hua, në shumicën e rasteve, pohojnë se nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë që kryejnë dhe kjo peshë rezulton më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha dhe në rritje krahasuar me periudhën paraardhëse për ndërmarrjet e mesme e të mëdha. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë vendosur të mos aplikojnë, për shkak se procesi u duket i vështirë apo për shkak se e vlerësojnë si më të thjeshtë huamarrjen nga burime alternative. Të dyja këto arsye vijnë të pohohen më shpesh nga ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme.

<sup>10</sup> Pyetjet e kësaj rubrike i janë drejtuar të gjithë kampionit të ndërmarrjeve, përfshirë edhe ato johuamarrëse.


**Grafik 6.2 Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për kredi sipas madhësisë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, pjesa kryesore e ndërmarrjeve të vogla (41%) pohojnë se do të merrnin hua nga burime alternative, me një peshë më të ulët në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Ndërkohë, ndërmarrjet e mesme (42%) dhe ato të mëdha (41%) kanë deklaruar kryesisht se do të kërkonin sërish kredi duke riaplikuar në një bankë apo institucion tjetër financiar. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë ka ardhur në rritje për të tre grupet e ndërmarrjeve, duke treguar prirjen për një kërkesë në rritje ndaj sektorit bankar. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve pohojnë shtyrje në kohë të planeve të tyre për zgjerim të veprimtarisë për shkak të mungesës së financimit. Ndonëse në rënie, kjo peshë rezulton më e lartë tek ndërmarrjet e vogla.

**Grafik 6.3 Mundësitë e financimit në rast mosfinancimi nga bankat**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 6.2 Procesi i huamarrjes dhe marrëdhënia me bankat

Indeksi i vështirësisë së procesit të huamarrjes nga bankat, për gjashtëmujorin e dytë 2019 ka rezultuar 0.37 për totalin e ndërmarrjeve duke mbetur i pandryshuar krahasuar me periudhën paraardhëse. Ky indeks vijon të mbetet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", për të tre grupet e ndërmarrjeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2019, niveli i vështirësisë rezulton në zbutje për ndërmarrjet e mëdha, por në rritje për ato të vogla.


**Grafik 6.4 Indeksi i vështirësisë së marrjes së një huaje nga bankat në vend**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Marrëdhënia me bankat, e matur nga indeksi përkatës, vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme". Ecuria e këtij indeksi gjatë periudhës ka shënuar rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, ndërsa për ndërmarrjet e mesme ka mbetur e pandryshuar.

**Grafik 6.5 Indeksi i rëndësisë së marrëdhënies me bankat**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Shënim: Indeksi llogaritet duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "e domosdoshme", 0.5 për alternativën "e rëndësishme" dhe vlerën 0 për alternativën "jo dhe aq e rëndësishme".*

### 6.3 Vështirësia e përfitimit të huasë<sup>11</sup>

*Kostoja e kredisë* vijon të konsiderohet si elementi kryesor që vështirëson përfitimin e një huaje bankare, në mënyrë më të theksuar për ndërmarrjet e vogla. Vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ndërkohë që ka ngelur e pandryshuar për ato të mesme. Në vijim të kostos së kredisë, edhe *kostoja e plotësimit të kërkesave të bankës* vijon të konsiderohet një vështirësi e konsiderueshme për të tre grupet e ndërmarrjeve, ndjekur nga vlerësimi i *kushteve për garantimin e kredisë* dhe *paqartësia e kërkesave të bankës apo procedurat burokratike*. Këto elemente kanë shënuar rritje për periudhën e vrojtuar, me një rritje më të theksuar për *koston e plotësimit të kërkesave të bankës*.

**Grafik 6.6 Niveli i vështirësisë së përfitimit të një huaje**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 6.4 Planifikimi i huamarrjes


Rreth 48% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se *"nuk ka asnjë mundësi"* që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, kjo peshë ka rënë për

<sup>11</sup> Për të vlerësuar vështirësinë e përfitimit të një huaje bankare, ndërmarrjeve iu është kërkuar të japin gjykimin e tyre për një sërë elementesh cilësore, sipas një sistemi vlerësimi me 5 shkallë, ku shkalla më e ulët e vështirësisë është 1 dhe shkalla më e lartë është 5. Për të marrë një vlerësim mesatar për secilin element cilësor, shkallët e vlerësimit nga 1 në 5 peshohen me peshat e përgjigjeve të dhëna nga ndërmarrjet.




ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por është rritur për ato të mëdha. Nga ana tjetër, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve të vogla që pohojnë se *ka pak mundësi* të marrin një kredi në gjysmën e parë të vitit 2020, ndërkohë që është rritur pesha e ndërmarrjeve të mesme që shprehen se *ka shumë mundësi* që diçka e tillë të ndodhë në gjashtëmuorin e ardhshëm. Gjithashtu, të gjitha grupet e ndërmarrjeve, por veçanërisht ato të mesme dhe të mëdha, kanë shënuar një rritje për alternativën "*është e sigurt*", duke u paraqitur më optimiste në planifikimin e huamarrjes. Kjo ecuri mund të sinjalizojë një rritje të kërkesës për kredi në afatin e shkurtër dhe të mesëm. Vlera e indeksit të *vlërësimit të planifikimit të huamarrjes* për gjashtëmuorin e ardhshëm<sup>12</sup> ka rezultuar 0.41 për totalin e ndërmarrjeve, e njëjtë me periudhën paraardhëse.

**Grafik 6.7 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të huamarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 6.8 Indeksi i planifikimit të huamarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>12</sup> Për të vlerësuar përgjigjet e ndërmarrjeve është ndërtuar indeksi mbi planifikimin e huamarrjes, llogaritur duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficienti për alternativën: "nuk ka asnjë mundësi" = 0.25; "ka pak mundësi" = 0.5; "ka shumë mundësi" = 0.75; "është e sigurt" = 1.